

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Lulluni kryetar, Isa Kelmendi dhe Albert Zogaj anëtarë, në çështjen juridike të paditësve K.R. dhe D.M. që të dy nga fshati “...” Komuna e Gjakovës, punëtor të shkollës fillore “...” në të njëjtin fshat nga i autorizuari S.M., kundër të paditurave Komuna e Gjakovës-Drejtorati i Arsimit në Gjakovë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Shërbimeve Publike në Prishtinë, kontest pune-për kompensimin e të ardhurave personale, vlera e kontestit 651.93 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuar të paditësve, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.73/08 të dt.15.05.2014, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt. 05.06.2017 mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të autorizuarit të paditësve : K.R. dhe D.M. që të dy nga fshati ... Komuna e Gjakovës, punëtor të Shkollës Fillore “...”, ndërsa, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.73/08 i dt.15.05.2014, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, është refuzuar kërkesë padia e paditësve: K.R. dhe D.M. që të dy nga fshati ... Komuna e Gjakovës, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohen të paditurat Komuna e Gjakovës- Drejtoria e Arsimit në Gjakovë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shërbimeve Publike në Prishtinë, që paditësit K.R. t’ia paguaj shumën prej 254.00 €, për muajin Nëntor 2007 dhe për 10 ditë të para të muajit Dhjetor 2007 shumën prej 98.32 € në shumë të përgjithshme prej 352.32 € (treqindpesëdhjetëdeyuroetridhjetëdeycentë) dhe D.M. për muajin Nëntor 2007 shumën prej 216.00 € dhe për 10 ditë të para të muajit Dhjetor 2007 shumën prej 83.61 €, në shumë të përgjithshme prej 299.61 € (dyqindëntëdhjetëenëntëegjashtëdhjetënjëcentë). Në emër të pagave të pa paguara me kamatë 3.5 %, duke filluar nga paraqitja e padisë datë 12.07.2008 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet kontestimore, krejt këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit si të pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesë padia të aprovohet si e bazuar ose i njëjti të prishet dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre konform me dispozitat e nenit 194 të LPK, gjeti se

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësit me padi dhe gjatë shqyrtimit përmes të përfaqësuesit të tyre të autorizuar kanë kërkuar kompensimin e punës së kryer gjatë fushatës parazgjedhore për zgjedhjet e 17 Nëntorit 2007, ku paditësit në atë kohë kanë qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar në Shkollën Filllore “...” në fshatin ... Komuna e Gjakovës, dhe atë në punë dhe detyrat e punës mësimdhënës. Të njëjtit kanë qenë në listat zgjedhore në zgjedhjet komunale të 17 Nëntorit 2007 dhe gjatë fushatës, sipas vërtetimeve, nuk kanë munguar asnjëherë nga procesi mësimor, por se të njëjtëve u është ndaluar paga e plotë për muajin Nëntor të vitit 2007 në shumat si në kërkesëpadi.

Gjykata e shkallës së parë pasi që ka administruar provat dhe vlerësuar ato në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike se, në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese rrethana se paditësit në periudhën për të cilën kërkohet kompensimi, të njëjtëve nuk iu është bërë pagesa. Nga vërtetimet e lëshuara nga Drejtori i shkollës K.R., është vërtetuar se paditësve u janë ndaluar paga e plotë për muajin Nëntor dhe paga për 10 ditët e para të muajit Dhjetor 2007 në shumat e cekura si në vërtetimet e lëshuara. Me njoftimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil, është vërtetuar se i njëjti organ me njoftimin për shtyp ka theksuar se shërbyesit civil të cilët kanë kandiduar në postet publike në zgjedhjet 2007, në mënyrë që ata të largohen nga lista e pagave, ashtu siç përcaktohet në aktet e mësipërme që i referohet Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/19, 2001/36 dhe Urdhëresës Administrative 2003/2. Në gjendjen e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë, ka përshkruar detajet e çështjes konkrete që u referohen paditësve.

Gjykata e shkallës së parë këtë gjendje faktike të çështjes, e ka mbështetur në dispozitën e nenit 28 par. 4 të Urdhëresës administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës, e cila ishte në fuqi që nga data 25.01.2003, ku janë përcaktuar kushtet dhe kriteret e ndër to edhe për nëpunësit civil të cilët paraqesin kandidaturën për ndonjë funksionon publik të zgjedhur, e të cilët duhet të marrin pushim pa pagesë nga shërbimi civil, i cili fillon nga data kur ata publikisht i shpallin kandidaturat e tyre.

Në situatën konkrete sipas gjykatës së shkallës së parë, bazuar në dispozitën e sipër cekur, të gjithë nëpunësit civil në këtë rast edhe paditësit, kanë qenë të detyruar të respektojnë dhe zbatojnë të njëjtën me rastin e paraqitjes së kandidaturave të tyre në zgjedhjet e vitit 2007. Gjykata e shkallës së parë i referohet edhe Udhëzimit administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal nr. 2007/10 në nenin 1 të tij, ku theksohet se punëtorëve të kandiduar në fushatë iu njihet e drejta në pushim me pagesë, por gjykata një gjë të tillë e ka vlerësuar si të pa mjaftueshme për ndonjë vendim ndryshe, nga se Udhëzimi administrativ i administrimit të pushtetit lokal i sipër cekur, për nga fuqia ligjore është akt më i ulët se urdhëresa administrative, kështu që bazuar në gjendjen e tillë faktike gjykata ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës ka vlerësuar përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë drejtë dhe të plotë dhe se në situatën e tillë është i pa bazuar pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditësve se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, nga se në situatën e tillë aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale nga dispozita e nenit 182 par. 2 pika n) të LPK, për të cilat pa të drejtë pretendohet në ankesë, e as ndonjë shkelje tjetër për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 194 të LPK.

Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në të njëjtën kohë drejtë ka bërë edhe zbatimin e të drejtës materiale, duke aplikuar dispozitat konkrete ligjore që i referohen kësaj çështje dhe duke dhënë arsyet përkatëse për një vendosje të tillë. Aktgjykimi i atakuar ka dispozitiv të kuptueshëm dhe në harmoni me provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, kështu që në situatën konkrete pretendimet ankimore nuk mund të kenë ndonjë ndikim, që gjykata të marr ndonjë vendim ndryshe, nga ai që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, lidhur me çështjen konkrete.

Me vet faktin se paditësit që të gjithë kanë marr pjesë në fushatën parazgjedhore për zgjedhjet lokale të muajit Nëntor vitit 2007, fakt ky i pa kontestuar nga palët, mirëpo, edhe pse paditësit kanë punuar dhe kanë vijuar procesin mësimor në cilësinë e nëpunësve civil (në atë kohë), është e detyrueshme që ata të cilët kandidojnë në zgjedhjet përkatëse, duhet të marrin pushim pa pagesë, ky detyrim derivohet nga dispozita e nenit 28.4 të Urdhëresës Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores 2001/36 për Shërbimin civil të Kosovës. (lex.specialist në raport me Ligjin themelor të punës në Kosovë), nga e cila dispozitë rezulton se nëpunësit civil që shpallin dhe pranojnë kandidatura për poste zgjedhore, janë të detyruar të marrin pushim pa pagesë, e kjo mëtej dmth. se atyre nuk iu takon kurrfarë kompensimi, pa marr parasysh a kanë punuar apo jo në vendin përkatës të punës për atë periudhë dhe këtë obligim ligjor ligjdhënësi e ka paraparë edhe për shkak të konfliktit të mundshëm të interesit (*shif për këtë nenin 29 të Urdhëresës Administrative të sipër cekur*).

Prandaj, konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje, e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, ndërsa pretendimet ankimore u refuzuan si të pa baza.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par. 1 pika d) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 3501/2014 më dt. 05.06.2017

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI
Gëzim Llulluni